



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.3710/9 prot.

Datë 12.01.2026

V E N D I M

Nr. 46/2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 12.01.2026 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Kërkesë për heqje dorë nga shqyrtimi administrativ i ankesës me numër ankimi elektronik A/2025/6210 datë 24.12.2025 dhe me Nr. 3710/2025 Prot., datë 29.12.2025 e operatorit ekonomik Besim Kamberi për procedurën e prokurimit “E hapur e thjeshtuar, mallra”, me Nr. REF-69833-11-21-2025, me objekt: “Blerje materiale pastrimi dhe dezinfektimi për njësitë shpenzuese të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë”, me fond limit 4,877,370.00 (katër milion e tetëqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë e treqind e shtatëdhjetë), zhvilluar më datë 05.12.2025 na autoriteti kontraktor, Universiteti i Mjekësisë Tiranë.

Ankimues: Operatori ekonomik Besim Kamberi me Nipt L42103023G dhe adresë: Rruga e Qelqit , Zona Kadastrale Nr 3866 Nr Pasurie 310/20 - Kashar, Tiranë

Autoriteti Kontraktor: Universiteti i Mjekësisë Tiranë
Adresa: Rruga e Dibrës, Nr. 371, 1005, Tiranë

Subjekte të Interesuara: Operatori ekonomik “KEJ Group” SHPK me Nipt. L81618008J dhe adresë: Rruga Sami Frasheri, Pallatet Agimi, Shkalla 22, Ap. 370 Tiranë

Operatori ekonomik “ANBIM” SHPK me Nipt. L81618008J dhe adresë: Autostrada TR-DR Km1 Zona kadastrale 2679 Numri pasurise 40/55 Tiranë.

Operatori ekonomik “ATLANTIK 3” SH.P.K me NIPT K22218003V dhe adresë: Autostrada Tirane - Durres, Km. 10, Rruga dytesore Vore – Albania, Vorë Tiranë

Operatori ekonomik “Biotek” SH.P.K me NIPT L82203011N dhe adresë: Lagjja Dëshmorët,1176,1-5, Nr pasurie 14/63 +1/11,vol 2, fq 179, ZK8603, Vlorë

Operatori ekonomik “Pastrime Silvio” SH.P.K me NIPT K91413010N dhe adresë: Njesia Bashkiake nr. 2, Rruga Fatmir Haxhiu, Pallati 2, Shkalla 10, Apartamenti 76, Kati I Tiranë

Operatori ekonomik “EURO DISTRIBUTION & DELIVERY” SH.P.K me NIPT L72003016A dhe adresë: Njësia Administrative Dajt, Rruga e Arbërit, Zona Kadastrale 3426, Nr.Pasurisë 541/2, Tiranë

Operatori ekonomik “NAOL” SH.P.K me NIPT L92201032D dhe adresë: Rruga Sami Frasheri, Pallatet e Aviacionit nr 2 Tiranë

Operatori ekonomik “MURATI D” SHPK me Nipt. K42003004T dhe adresë Rruga Kavajes, Ish- Kombinati Ushqimor, Godine 1- kateshe, Tiranë

Baza Ligjore:

Nenet 30 dhe 117 të ligjit nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*” i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 766, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr.500/2020, datë 05.11.2020 “*Rregullore për marrjen e masave organizative për ushtrimin e veprimtarisë së institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID-19*”.

Komisioni i Prokurimit Publik pasi shqyrtoi kërkesën e ankimuesit dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga 3 (tre) anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

I.4. Ankimuesi Besim Kamberi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 21.11.2025 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, procedura e prokurimit prokurimit “E hapur e thjeshtuar, mallra”, me Nr. REF-69833-11-21-2025, me objekt: “Blerje materiale pastrimi dhe dezinfektimi për njësitë shpenzuese të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë”, me fond limit 4,877,370.00 (katër milion e tetëqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë e treqind e shtatëdhjetë), zhvilluar më datë 05.12.2025 na autoriteti kontraktor, Universiteti i Mjekësisë Tiranë.

II.2. Në datën 05.12.2025 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.3. Në datën 12.12.2025, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. “ANBIM” SHPK	3,179,919.6 lekë	s’kualifikuar
2. “ATLANTIK 3” SHPK	4,243,600 lekë	s’kualifikuar
3. “BESIM KAMBERI” P.F	4,197,270 lekë	kualifikuar
4. “Biotek” SHPK	3,373,987.5 lekë	s’kualifikuar
5. “Pastrime Silvio” SH.P.K	3,930,530 lekë	s’kualifikuar
6. “MURATI D” SHPK	3,160,443 lekë	s’kualifikuar
7. “EURO DISTRIBUTION & DELWERY” SI-IPK	3,132,820 lekë	s’kualifikuar

8. "KEY GROUP" SHPK	3,948,360 lekë	kualifikuar
9. "NAOL" SHPK	-	s'kualifikuar

II.4. Në datën 12.12.2025 operatori ekonomik Besim Kamberi është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave, si dhe me kualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi

II.5. Në datën 18.012.2025, autoriteti kontraktor ka publikuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik "Publikimi i Njoftimit të Fituesit Paraparak" për procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi.

II.6. Në datën 24.12.2025, pranë Komisionit të Prokurimit Publik është dorëzuar ankesa me numër ankimimi elektronik A/2025/6210 datë 24.12.2025 dhe me Nr. 3710/2025 Prot., datë 29.12.2025 e operatorit ekonomik Besim Kamberi për procedurën e prokurimit "E hapur e thjeshtuar, mallra", me Nr. REF-69833-11-21-2025, me objekt: "Blerje materiale pastrimi dhe dezinfektimi për njësitë shpenzuese të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë", ku u konstatua se objekti i saj lidhet me me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik "KEJ Group" SHPK, lënien në fuqi të vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e operatorëve ekonomikë "ANBIM" SH.P.K, "ATLANTIK 3" SH.P.K "Biotek" SH.P.K "Pastrime Silvio" SH.P.K "MURATI D" SH.P.K "EURO DISTRIBUTION & DELIVERY" SH.P.K "NAOL" SH.P.K si dhe shtim arsye skualifikimi për operatorët ekonomikë "ANBIM:" SHPK dhe "MURATI D" SHPK.nga procedura e prokurimit të sipërcitua nga proceura e mësipërme

II.7. Bazuar në nenin 112 pika 3 të ligjit 162/2020 "Për prokurimin Publik" Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe formularin për publikim Nr. 3701/1 prot., datë 30.12.2025, me pretendimet që operatori ekonomik Besim Kamberi ka parashtruar në ankesësën e tij me nr. 3710 prot, datë 29.10.2025.

II.8. Më datë 30.12.2025 Operatori ekonomik Besim Kamberi ka ngarkuar në sistemin e ankesave elektronike shkresën e datës 30.12.2025 drejtuar Komisionit të Prokurimit Publik dhe Universitetit të Mjekësisë Tiranë me përmbajtje si më poshtë vijon:

"Shoqeria jone BESIM KAMBERI PF shpjegon arsyet e heqjes dore nga ankesa si me poshte vijon: Kemi ndjekur te gjitha procedure per tu shpallur fitues ne kete procedure prokurimi duke ndjekur dhe hapin e rradhes per Ankese prane Autoritetit Kontraktor dhe Komisionit te Prokurimit Publik por duke qene se nje pjese te produkteve kemi kontrata bashkepunimi me subjekte te tjera, jemi informuar ditën e sotme qe per disa produkte te kerkuara nga AK nuk mund ti sigurojme dot sipas specifikimeve teknike, shprehim angazhimin tone qe te mos krijojme vonesa ne kete procedure prokurimi duke shkaktuar dem per autoritetin kontraktor persakohe ndodhemi perball faktit qe per disa produkte nuk mund ti mbulojme dot. Shpresojme qe dashamiresia jone te merret parasysh dhe serioziteti jone te jete ne kushtet e pranimit pasi nuk duam te behemi pengese persakohe nuk arrijme te marrim angazhimin per realizimin e kesaj kontrate (per zhvillime te cilat nuk jane ne doren tone si subjekt "

II.9. Me shkresën nr.3710/3 prot.,, datë 05.01.20226 Komisioni i Prokurimit Publik i është drejtuar operatorit ekonomik Besim Kamberi për përcaktimin e objektit të prokurimit, numrin e referencës, fondin limit dhe autoritetin kontraktor për të cilin ai ka ankimuar dhe kërkon të heqë dorë.

II.10 Më datë 08.01.2026 operatori ekonomik Besim Kamberi ka dërguar të saktësuar shkresën për heqje dorë nga procedura e prokurimit objekt ankimi

II.11. Nëpërmjet shkresës të protokolluar me tonën me nr. 3710/4 datë dhe 07.01.2026 prot., dhe nr. 3710/6 prot., datë 09.01.2026, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik vendimi i KSHA-së lidhur me shqyrtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues Besim Kamberi ku rezulton se ankesa e tij është konsiderur e ezauruar poër sa kohë ka hequr dorë nga ankimi.

II.10. Nga shqyrtimi i akteve të ndodhura në fashikullin e shqyrtimit administrativ rezulton, se nuk janë paraqitur argumente nga operatorë ekonomikë, në cilësinë e subjektit të interesuar, në përputhje me nenin 113 të LPP-së i ndryshuar.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesave, dokumentacionit bashkëngjitur saj si dhe informacionit e dokumentacionit të paraqitur nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me kërkesën e operatorit ekonomik Besim Kamberi, për të hequr dorë nga ankesa e bërë në lidhje me procedurën e prokurimit “E hapur e thjeshtuar, mallra”, me Nr. REF-69833-11-21-2025, me objekt: “Blerje materiale pastrimi dhe dezinfektimi për njësitë shpenzuese të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë”, me fond limit 4,877,370.00 (katër milion e tetëqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë e treqind e shtatëdhjetë), zhvilluar më datë 05.12.2025 na autoriteti kontraktor, Universiteti i Mjekësisë Tiranë, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në nenin 117 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar parashikohet:
“1. Ankimesi ka të drejtë që të tërheqë ankesën e depozituar në çdo kohë përpara përfundimit të afatit për shqyrtimin e saj nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik. Tërheqja e ankesës konsiderohet si mospranim ankese dhe ankimesit nuk i kthehet tarifa e ankesës.

2. Në rast të tërheqjes së ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik ndërpret shqyrtimin e saj menjëherë dhe merr vendim për mbylljen e çështjes.”

III.1.2. Bazuar në parashikimet e mësipërme ligjore, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se operatori ekonomik ankimues është në të drejtën e tij, që në çdo kohë përpara përfundimit të afatit për shqyrtimin e ankesës nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik, të kërkojë të

heqë dorë nga pretendimet e parashtruara në ankimimin e tij. Në këto kushte, nisur nga kërkesa e operatorit ekonomik ankimues për heqje dorë nga ankesa e bërë, në zbatim të pikës 2, të nenit 117 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik do të ndërpresë menjëherë shqyrtimin e ankesës me numër ankimi elektronik nr. ankimi elektronik A/2025/6210 datë 24.12.2025 dhe me Nr. 3710/2025 Prot., datë 29.12.2025, të operatorit ekonomik Besim Kamberi për procedurën e prokurimit objekt-ankim, si dhe do të mbyllë çështjen administrative.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30 dhe 117 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të përfundojë procedimin administrativ për procedurën e prokurimit “E hapur e thjeshtuar, mallra”, me Nr. REF-69833-11-21-2025, me objekt: “Blerje materiale pastrimi dhe dezinfektimi për njësitë shpenzuese të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë”, me fond limit 4,877,370.00 (katër milion e tetëqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë e treqind e shtatëdhjetë), zhvilluar më datë 05.12.2025 na autoriteti kontraktor, Universiteti i Mjekësisë Tiranë
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
3. Ngarkohet zyra e financës, të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit, të tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik Besim Kamberi.
4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Gjergj Mersini

Anëtar
Kreshnik Ternova

Nënkryetar
Fiorent Zguro

